



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 840 Prot



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

Nr. 844 Prot

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Nisur nga;

Shqetësimi i opinionit publik shqiptar për nivelin e lartë të korrupsionit në administratën publike në Shqipëri, si dhe
Prioritetet e institucioneve shqiptare dhe kërkesat e vazhdueshme të organizmave të ndryshme ndërkombëtare për forcimin e luftës kundër fenomenit të korrupsionit në administratën publike në Shqipëri;

Me synim:

Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për rritjen e efektivitetit të goditjes së akteve korruptive, konfliktit të interesit dhe mosdeklarimit apo deklarimit të rremë të pasurive nga punonjësit e administratës publike.

Në mbështetje të:

Ligjit nr. 8737, datë 12. 02. 2001 "*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*" të ndryshuar, si dhe,
Ligjit nr. 9367, datë 7. 04. 2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*" të ndryshuar, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 "*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*", i ndryshuar, dhe nenit 17, germa "ç" që përcakton se "*bashkëpunon me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik*"

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm znj. Ina Rama dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm zj. Fatmira Laska, që këtu e më poshtë do t'i referohemi palë, bien dakord të zbatojnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, si më poshtë;

Neni 1

Qëllimi

1. Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjellët ndërmjet palëve, për shkëmbimin e informacioneve për subjektet e deklarimit periodik të interesave private në ILDKP, me qëllim evidentimin e saktë të rasteve të mosdeklarimit apo deklarimit të rremë të pasurisë, të rasteve të konfliktit të interesit dhe korrupsionit nga punonjësit e administratës publike.
2. Marrja e masave për plotësimin e rregullt të kallëzimeve penale, kryerjen e hetimeve paraprake, ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në afate sa më të shpejta, në zbatim të ligjit penal dhe procedural penal.
3. Rritja e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional në luftën kundër veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit.
4. Informimi për çështje të tjera me interes të përbashkët të Palëve në këtë Marrëveshje.

Neni 2

Detyrime të përbashkëta të palëve:

A. Personat e kontaktit

1. Palët për zbatimin e kësaj marrëveshje caktojnë nga një person kontakti për secilin institucion.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në vazhdimësi, në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni. Objekti i shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre do të jetë sipas nenit 1 të kësaj marrëveshje.
3. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshje.

B. Organizmi i takimeve të përbashkëta.

Palët marrim përsipër që të organizojnë takime të përbashkëta periodike ndërmjet punonjësve të ILDKP, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të specializuar për hetimin e veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, me qëllim shkëmbimin e opinioneve dhe eksperiencave për kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e drejtë të rasteve të mosdeklarimit, deklarimit të rremë, konfliktit të interesit apo korrupsionit, të cilat janë objekt i punës së dy institucioneve.

Neni 3

Detyrimet e ILDKP

1. Në rastet kur ILDKP bën kallëzim penal në prokurori, materiali, përveç kërkesave të parashikuara në nenin 281 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të shoqërohet edhe me një relacion përmbledhës të faktit të konstatuar dhe elementëve të veprës penale të dyshuar; me proces verbalet dhe aktverifikimet e mbajtura nga inspektorët e ILDKP në lidhje me faktin e konstatuar dhe të referuar si vepër penale; me observacionet e personave përgjegjës ku paraqiten pretendimet e tyre; çdo dokument tjetër që është i nevojshëm për të vërtetuar konstatimet e ILDKP-së në lidhje me kryerjen e veprës penale për të cilën është bërë kallëzimi.
2. Në çdo rast që ILDKP bën kallëzim në prokurorinë kompetente, një kopje e kallëzimit së bashku me relacionin përmbledhës, i dërgohet për dijeni Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
3. Në rastet kur ILDKP konstaton konflikt interesi në punën e zyrtarëve publik, i dërgon Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm një relacion përmbledhës në lidhje me konfliktin e konstatuar dhe zgjidhjen e tij, me qëllim që të vlerësohet nëse mund të regjistrohet procedim penal.
4. Në rastet kur prokuroria është duke hetuar procedim penal me subjekt punonjës të administratës shtetërore, me kërkesë të Drejtuesit të 'Prokurorisë' kompetente, ILDKP paraqet një kopje të dokumentacionit që disponon në lidhje me zyrtarin që është duke u hetuar, pavarësisht nga lloji i veprës penale që po hetohet.

Neni 4

Detyrimet e prokurorisë

1. Gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe gjykimit të procedimeve penale të regjistruara mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga ILDKP, pikat e kontaktit do të realizojnë, sa here që të jetë e nevojshme, takime ndërmjet inspektorëve të ILDKP që kanë ndjekur rastin dhe prokurorëve që ndjekin procedimin penal, me qëllim sqarimin sa më të plotë të rrethanave dhe fakteve objekt hetimi.
2. Në përfundim të hetimeve paraprake Drejtuesi i Prokurorisë kompetente njofton me shkrim ILDKP dhe Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm për mënyrën e përfundimit të procedimeve penale të regjistruara mbi bazën e kallëzimit të paraqitur nga ILDKP.
3. Në rastet kur nga hetimet e procedimeve penale të ndryshme prokurorët nuk konstatojnë vepër penale, por shkelje administrative të cilat janë objekt punë i ILDKP, Drejtuesi i Prokurorisë kompetente dërgon për dijeni një kopje të vendimit të pushimit në ILDKP.

Neni 5

Administrimi i informacionit

1. Informacioni i shkëmbyer mes Palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", ligjin nr. 8517, datë 22.7.1999 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

2. Gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje asnjë nga institucionet apo pikat e kontaktit nuk do të ushtrojë ndikim për të mos u dërguar një kallëzim penal në prokurori.

Neni 6 Ndryshime

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjellët me shkrim të palëve.

Neni 7 Përfundimi i Marrëveshjes

1. Marrëveshja mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi hyn në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër.
2. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga kjo Marrëveshjeje, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve. Marrëveshja përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe dy të tjera në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u lidh sot më datë 13 Mars 2008.

PËR ZYRËN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

PËR INSPEKTORATIN E LARTË TË

DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

INSPEKTORI PËRGJITHSHËM

INA RAMA



FATMIRA LASKA

